

Pranuar me dt. 03.10.2025			
Njësia orig.	Numër	Nr.ekzempl.	Vlera
	8235		

Universiteti i Prishtinës



UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Fakulteti i Mjekësisë

Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-512221 URL: <http://www.uni-pr.edu>

Ref. nr.

Prishtinë, 2025

Për: Këshillin mesimor shkencor të Fakultetit të Mjekësisë
Cc: Prof. Dr. Sefedin Muçaj, Dekan i Fakultetit të Mjekësisë
Nga: Komisioni për shqyrtimin e ankesave të transfereve nga Universitetet tjera në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 2025/26
Lënda: Raport i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Transfereve nga Universitetet tjera në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 2025/26

Komisioni për shqyrtimin e ankesave të transfereve të studenteve për vitin akademik 2025/2026 në Fakultet të Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, i emëruar me vendim të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë, me numër 8000, të dates 26.09.2025, i përbërë nga:

1. Prof. Asoc. Dr. Violeta Lokaj-Berisha – Kryesuese
2. Prof. Ass. Dr. Xhevat Jakupi – Anëtar
3. Ass. Dr. Merita Hashani – Anëtare

ka shqyrtuar ankesat (20) e aplikuesve në konkursin për transfer të studentëve bazuar në vendimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës (datë 23/09/2024) dhe Statutin e Universitetit të Prishtinës (të miratuar në 19.07.2024) - neni 110, 111 dhe 112.

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar në konkurs si dhe ankesave të aplikantëve, komisioni ka përpiluar raportin me shkrim me datën 02.10.2025, për prezantim para Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë.

Kandidatët me ankesë për moslejim transferi në vitin e 5-të të programit Mjekësi e Përgjithshme:

1. **Suel Ahmeti**, ankesa me numër prot. 8106: kërkesë për rishqyrtim të dokumentacionit për verifikim të notes mesatare të raportuar si 7.09 në vend të 7.9 - **Ankesa e bazuar** sepse certifikata e notave (ref. 22-2884/2, date 10.09.2025) e vërteton notën mesatare **7.9**. Ndërsa kjo ishte evidentuar edhe nga komisioni në dokumentacionin e shqyrtuar konsiderohet se lëshimi ishte teknik. - **Komisioni i propozon këshillit të Fakultetit të Mjekësisë rangimin e**

kandidatit në fjalë në listën përfundimtare konform kriterit për plotësimin e kuotës prej 5%.

2. **Fjolla Gashi**, ankesa me numër prot.8156: kërkesë për rritje të numrit të transfereve. - **Ankesa e pabazuar sipas kuotës 5%**
3. **Enisa Haxhijaj**, ankesa me numër prot 8054: kërkesë për rritje të numrit të transfereve – **Ankesa e pabazuar sipas kuotës 5%**
4. **Fitore Lajçi**, ankesa me numër prot. 8080: kërkesë për shqyrtim të vendimit të komisionit pranues. – **Ankesa e pabazuar për shkak të vitit përsëritës.**
5. **Diamant Gashi**, ankesa me numër prot. 8152: kërkesë për rishqyrtim të vendimit – **Ankesa e pabazuar, viti përsëritës**
6. **Mentor Ajvazi**, ankesa me numër prot. 8153: kërkesë për rishqyrtim të vendimit – **Ankesa e pabazuar, viti përsëritës**

Kandidatët me ankesë për moslejim transferi në vitin e 4-të programit Mjekësi e Përgjithshme:

1. **Anisa Lipovica**, ankesa me numër prot 8033: kërkesë për rritje të numrit të transfereve – **Ankesa e pabazuar**
2. **Adisa Çorraj**, ankesa me numër prot. 8132: kërkesë për sqarim të refuzimit për tranfer përkundër plotësimit të kriteve të parapara - **Ankesa e pabazuar, sipas kuotës 5%.**
3. **Besarta Matarova** - ankesa me numër prot. 8112: kërkesë për rritje të numrit të transfereve, marrje në konsideratë të numrit të kredive dhe jo vetëm notën mesatare dhe vështirësitë financiare - **Ankesa e pabazuar (ref. neni 112 i Statutit të UP)**
4. **Enis Krasniqi**, ankesa me numër prot. 8125, ankesë për raportim të pasaktë të notes mesatare 8.02 në vend të 8.2- **Ankesa e bazuar (nota mesatare e kandidatit është 8.2, por nuk e ndryshon radhitjen në listën preliminare pasi që kandidati i fundit i pranuar është me notë mesatare 8.63)**
5. **Vesa Shabani**, ankesa me numër prot.8034: kërkesë për rritjen e numrit të tranferve - **Ankesa e pabazuar sipas kuotës 5%**

Kandidatët me ankesë për moslejim transferi në vitin e 3-të programit Mjekësi e Përgjithshme:

1. **Dina Gashi**, ankesa me numër prot.8015: kërkesë për rishikim të vlerësimit të kredive dhe rangimit në listë në raport me kandidatin nr. 16 – **Ankesa e pabazuar (mungojnë kreditë e mjaftueshme për vitin e dytë, ndërsa rangimi para kandidatit me nr 16, poashtu të refuzuar, nuk ndikon në listën preliminare).**
2. **Erita Nuredini**, ankesa me numër prot.8016: ankesë për llogaritje të gabuar të kredive dhe rritje të numrit të transfereve – **Ankesa e pabazuar (i mungojnë kreditë e mjaftueshme për vitin e dytë)**
3. **Melisa Tyrbedari**, ankesa me numër prot.8123: kërkesë për shqyrtim të refuzimit. – **Ankesa e pabazuar (viti i regjistrimit 2021/22)**
4. **Rea Qorolli**, ankesa me numër prot. 8003: kërkesë për rishikim të kredive dhe plotësim me transkriptë të përditësuar – **Ankesa e pabazuar (mungojnë kreditë e nevojshme për vitin e**

dytë, ndërsa dokumentet shtesë nuk pranohen pas përfundimit të afatit të aplikimit. Ref. “Vërejtja” në Njoftimi nr. 6966, date 01.09.2025)

5. **Vesa Ademi**, ankesa me numër prot.8064: kërkesë për rishqyrtim të vendimit të komisionit për pranim – **Ankesa e pabazuar**

Kandidatët me ankesë për moslejim transferi në vitin e 3-të programin Stomatologji:

1. **Zade Stajki**, ankesa me numër prot. 8121: kërkesë për pranim të dëshmimeve shtesë - **Ankesa e pabazuar** (referencë: “Vërejtja” në Njoftim nr. 6966, date 01.09.2025)

Kandidatët me ankesë për moslejim transferi në vitin e 4-të të programit Stomatologji

1. **Mirjetë Zogaj**, ankesa me numër prot. 8113: kërkesë për rishqyrtim të vendimit – **Bazuar në dëshmitë e kandidatës për “rrethana të jashtëzakonshme familjare”, komision i propozon Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë, shqyrtim të dosjes së kandidatës, për mundësi mbështetëse të kërkesës së saj në kuadër të kuotës 5%, meqenëse ka vende të lira dhe nuk ka kundër kandidat.**

Kandidatët me ankesë për moslejim transferi në vitin e 3-të programit Farmaci

1. **Sadije Ajeti**, ankesa me numër prot. 8683: kërkesë për rishqyrtim të vendimit - **Ankesa e pabazuar mbështetur në kuotën 5%.**

Kandidatët me ankesë për moslejim të ndërrim të programit nga Stomatologji në MP – viti I V -të.

1. **Blerton Mulliqi**, ankesa me numër prot. 8160: kërkesë për rishqyrtim vendimi - **Ankesa e pabazuar, ngase nuk ka përputhje në përmbajtje të lëndëve mësimore në mes të drejtimeve** (referencë: planprogrami i vitit 2016 për MP dhe S).

Komisioni për shqyrtimin e ankesave të transfereve vërejtë shqetësim të kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret por në raport me kuotën 5% janë refuzuar. Të njëjtit theksuan se në bazë të njoftim publik dhe me rastin e shtyrjes së afatit, citoj: *“një pjesë e kandidatëve të pranuar kanë siguruar transkripte të notave me provime shtesë dhe ne që kemi aplikuar me kohe jemi dëmtuar”*. Bazuar në kriteret e plotësuar dhe situatën e rëndë financiare të kandidatëve, komisioni i propozon Këshillit të Fakulteti të Mjekësisë, Universitetit të Prishtinës, të merr në konsideratë ankesat e tyre duke u bazuar në numrin e tanishëm të studentëve për vitet përkatëse.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave:

1. Prof. Asoc.Dr. Violeta Lokaj-Berisha – Kryesuese
2. Prof. Ass. Dr. Xhevat Jakupi – Anëtar
3. Ass. Dr. Merita Hashani – Anëtare

